



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRRI

02 Nr. / Br 896/21

Nr. i sq. / Br. st _____

Data: / Datum 09 08. 2021

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenin 67, “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe kërkesën e Drejtorit për Shërbime Publike dt. 28.07.2021 e cila i referohet projektit të GIZ-it “Shërbime të Qëndrueshme Komunale –SMS”, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË GRUPIT PUNUES

1. Formohet grupi punues për përgatitje të Planit të Veprimit për eliminim të përhershëm të deponive ilegale në Komunën e Vushtrrisë.
2. Grupi Punues ka këtë përbërje:
 - 2.1 z. **Islam Latifi**, - kryesues
 - 2.2 z. **Mentor Jashari**, anëtar
 - 2.3 znj. **Arta Haxhaj**, anëtare
 - 2.4 z. **Safet Ahmeti**, anëtar
 - 2.5 z. **Bajrush Gërxhaliu**, anëtar
 - 2.6 z. **Isa Krasniqi**, anëtar
3. Grupi punues në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përgatis Planin e Veprimit për eliminim të përhershëm të deponive ilegale në territorin e Komunës së Vushtrrisë, projekt i GIZ-it “Shërbime të Qëndrueshme Komunale –SMS”, referuar bashkëpunimit për forcimin e kapaciteteve për sektorin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta.
4. Grupi punues do të bashkëpunoj ngushtë me sponzorues të këtij projekti me rëndësi për komunën.
5. Për punën e tij grupi punues do të mbaj të informuar në mënyrë të rregullt Kryetarin e Komunës.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetari i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	898/21
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	09.08.2021
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, nenit 17 pika 1.1 të Rregullores së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë Nr.01/2018 për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione personave juridikë – OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë Nr.144/18 të dt.31.05.2018, vendimit të Kuvendit Nr.64/21 të dt.25.03.2021 si dhe në bazë të Propozimit Nr. 03/84/21 të dt.04.08.2021 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. z.Mehmet Sadiku – Shoqata Franko Kosovare në Mitrovicë, i lejohen mjete financiare në shumë prej 200 € (dyqind euro), për organizimin e Ditës së Mërgimtarëve në Shalë të Bajgorës ku do të marrin pjesë edhe qytetarë nga Vushtrria.
2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport..
3. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Vushtri.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Palës si dhe
- Arkivit të Sekretarisë



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRIN

02 Nr. / Br 950/21

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 11.08.2021

VUSHTRRI - VUCITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), si dhe nenit 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Kërkesën e Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dt. 10.08.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M P E R F O R M I M T Ë K O M I S I O N I T

1. Formohet komisioni profesional për vlerësim të gjendjes në terren për vlerësim të dëmit në terren në këtë përbërje:
 - 1.1 **Ahmet Shuku**, kryesues i komisionit,
 - 1.2 **Isa Latifi**, anëtar,
 - 1.3 **Egzon Haradinaj**, anëtar.
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë vlerësimin e gjendjes faktike të murit në Rr. "Haxhi Dini" në fsh. Novolan me rastin e implementimit të projektit Asfaltimi i rrugës lokale në fsh. Novolan, - pjesë e kontratës së punës nr. VU644-20-4423-5-1-1/C330, 14, Nr. 216/21, dt. 12.05.2021.
3. Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e vlerësimit të gjendjes faktike të këtij rasti.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02Nr. 802/21, dt. 19.07.2021.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	1029 / 21
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	17. 08. 2021
VUSHTRRI - VUČITRN	




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturave: numër 07, datë 16.07.2021, në shumë prej 402.00 € (katërqindedy euro) dhe nr. 08 datë 17.07.2021 në shumë prej 297.00 (dyqindenëntëdhjeteshtatë euro), në llogari të Shoqatës së Martirëve "Martirët e Lirisë 1998/99" në Vushtri – drekë me ushqim tradicional me rastin e organizimit të manifestimit "Ditët e Diasporës" në muajin korrik 2021.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë rini dhe Sport.
3. Fatura në kopje origjinale është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- DKRS
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër 21-SHV01-002-167 datë 02.08.2021, në shumë prej 280.00 € (dyqindetëdhjetë euro) në llogari të Hotel “Amazona”, Milloshevë, Obiliq, - për shpenzime të krijuara nga Kryetari i Komunës me mysafirë zyrtarë nga Emiratet e Bashkuara Arabe.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Kryetarit të Komunës.
3. Fatura në kopje origjinale është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Shtabi emergjent për COVID-19

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/32 datë 28.08.2021 për Masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, Shtabi Emergjent i komunës për mbrojtje nga pandemia COVID-19 në takimin në distancë të mbajtur me datën 30.08.2021, merr:

V E N D I M

1. Anulohet mbajtja e Akademisë Përkujtimore me rastin e shënimit të "Ditës së Dëshmorëve" në Komunën e Vushtrrisë e paraparë të mbahet me datën 01 shtator 2021.
2. Shënimi i kësaj date të bëhet vetëm me vendosje ne kurorave të luleve në varrezat e Dëshmorëve nga delegacionet e caktuara nga Kryetari i Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kabineti i Kryetarit të komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës –
Kryesues i Shtabit Emergjent

Vendimi iu dërgohet:

- Shefit të Kabinetit të Kryetarit
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCHITRIN
Nr. Dk / Dk 1077-1/21
Na / Rg / Dk st
Data: / Datum 31.08.2021
VUSHTRRI - VUCHITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 dhe 17 shkronja "g" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 54 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenin 67 shkronja "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/32, dt. 28.08.2021, Kryetari i Komunës si kryesues i shtabit Emergjent me datën 31.08.2021 merr këtë:

V E N D I M

1. Riaktivizohet Qendra Operative Emergjente Lokale në Komunën e Vushtrrisë pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për masat e reja anti-Covid.
2. Qendra Operative Emergjente Lokale është në shërbim 24/h.
3. Numrat e kontaktit dhe e-maili; **0800 42000 (pa pagesë) E-maili: shtabi.vushtrri@rks-gov.net**
4. Qendra Operative Emergjente Lokale i raporton Kryetarit të Komunës dhe Qendrës Operative Regjionale përkatësisht Qendrës Operative të Agjencisë.
5. Qendra Operative Lokale është në funksion deri në marrjen e një vendimi tjetër.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Dërgohet:

- Qendrës Operative
- Zyrës për Informim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRË	
02 Nr./Br	1045/21
Nr./Sq./Br.st	-02-
Data:/Datum	25.08.2021
VUSHTRRI - VUÇITRË	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Marrëveshjen Nr. 542/21 dt. 17.05.2021, si dhe Aneks Marrëveshjen nr.1043/21, datë 24.08.2021 në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A, në Vushtri për Kryerje të Shërbimeve Komunale, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR MENAXHIM/MBIKËQYRJE TË
MARRËVESHJES

1. Formohet komisioni për menaxhim/mbikëqyrje të implementimit të Marrëveshjes Nr. 542/21 datë 17.05.2021 si dhe Aneks marrëveshjes nr.1043/21, datë 24.08.2021 për Kryerje të Shërbimeve Komunale, të lidhur në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A, në Vushtri, **që ka të bëj me shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave publike të komunës.**
2. Komisioni për menaxhim/mbikëqyrje ka këtë përbërje:
2.1 Besim Muzaqi, kryesues
2.2 Afrim Fazliu, anëtar
2.3 Mehmet Ferati, anëtar
3. Komisioni për menaxhim/mbikëqyrje, i cekur në pikën dy të këtij vendimi, do të bëjë mbikëqyrjen e kryerjes së punëve të mirëmbajtjes së të gjitha hapësirave publike të përfshira në nenin 3 të Marrëveshjes Nr. 542/21 datë 17.05.2021, si dhe aneks marrëveshjen nr.1043/21, datë 24.08.2021 në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A, në Vushtri për Kryerje të Shërbimeve Komunale.
4. Mbikëqyrja e zbatimit të marrëveshjes dhe aneks marrëveshjes duhet të bëhet si në aspektin e cilësisë ashtu edhe sasisë së kryerjes së punëve, bazuar në kërkesat dhe planin e Drejtorisë për Shërbime Publike për mirëmbajtje të sipërfaqeve/hapësirave publike.
5. Komisioni për menaxhim/mbikëqyrje në fund të çdo muaji duhet të paraqes raport me shkrim për shërbimet e kryera dhe dorëzoj në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave për kryerje të pagesave.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02Nr.711/21, dt. 22.06.2021.

7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi ju dërgohet :

- Drejtorisë për Shërbime Publike
- NPL "Përparimi" SH.A
- Komisionit për menaxhim/mbikëqyrje
- Arkivit të sekretarisë.